



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 Nr. 01-4198/1

09.10. 2024

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 8 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 11¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 50 dhe nenin 50-a nga Ligji i njëjtë, në pajtim me nenin 15 paragrafi (1) nënparagrafi 7 dhe neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 11 të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) nr.01-3732/1 datë 29.07.2019 dhe Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë ark.nr.02-4118/3 datë 09.10. 2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 38-të mbajtur më 09.10. 2024 miratoi:

REGULLORE PER NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
RREGULLORES PËR MBROJTJEN E TË MITURVE

Neni 1

Me këtë rregullore kryhet ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për mbrojtjen e të miturve (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr.172/14), në tekstin e mëtejme: Rregullore.

Neni 2

Në kreun “I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME”, neni 1 i Rregullores ndryshohet si vijon:

“Neni 1

Lënda e Rregullores

Të gjithë ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale, përkatësisht transmetuesit dhe ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë - dhe personat fizikë (ndikues/vlogger/krijues) dhe personat juridikë, kanë detyrimin të mbrojnë të miturit nga përmbajtje – programe/video të krijuara nga shfrytëzuesit/audio dhe komunikime komerciale audiovizuale, të cilat mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin e tyre fizik, mendor ose moral, veçanërisht nga përmbajtjet pornografike², pornografi për fëmijë³

ose dhunë e tepruar⁴. Përmbajtja me pornografi dhe dhunë e tepruar mund të transmetohet/bartet vetëm në formë të koduar ndërsa përmbajtja me pornografi për fëmijë është plotësisht e ndaluar.

Përmbajtje të tjera – programet/video të krijuara nga shfrytëzuesit që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik,

¹ Paragrafet 8 dhe 9 fshihen, shih: neni 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime mediatike audio dhe audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.248/18).

² Pornografia për nevojat e Rregullores për mbrojtjen e të miturve, janë tërësi ose pjesë e materialit audiovizuel të shfaqur me qëllim bazë dhe funksion të kënaqjes së dëshirës seksuale, nëpërmjet përshkrimeve, skenave dhe/ose pamjeve të pornografisë seksuale, marrëdhënieve seksuale, masturbimit dhe/ose stimulimit seksual, që nuk përfaqësojnë element thelbësor estetik, humanist ose informues në kontekst të temës së përpunuar artistikisht ose të temës së analizuar gazetareske.

mendor dhe/ose moral të të miturve duhet të kenë shenjë adekuate. Përveç kësaj, transmetuesit duhet t'i transmetojnë në periudhë kohore të përshtatshme gjatë ditë-natës.

Kjo Rregullore përcakton mënyrën e kategorizimit të përmbajtjeve, periodhat e transmetimit të programeve audiovizuale, format e paralajmërimit akustik dhe vizual, shenjat vizuale, masat teknike që duhet të ndërmerren nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë për mbrojtjen e të miturve, si dhe mënyrën e veprimit të ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale”.

Neni 3

Në kreun “I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME”, neni 2 i Rregullores ndryshohet si vijon:

"Neni 2 Fjalorth

Shprehjet e veçanta të përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin e mëposhtëm:

- **Të mitur** janë personat nën moshën 18 vjeç;
- **Përmbajtje të tjera – programe/video të krijuara nga shfrytëzues/komunikimet komerciale që mund të dëmtojnë të miturit** janë njësitë audiovizuale ose pjesët përbërëse të tyre që përshkruajnë shkallë me intensitet të ndryshëm të dhunës, erotizëm, sjellje seksuale të ndaluara me ligj, shprehje dhe gjeste të turpshme, sjellje të ndryshme që janë të lehta për t'u imituar, të dëmshme për shëndetin dhe të rrezikshme për sigurinë e individit dhe komunitetit, si dhe sjellje fyese për dinjitetin njerëzor, përmbajtje dhe komunikime komerciale për lojëra të veçanta të fatit, etj.;
- **Video e krijuar nga përdorues(shfrytëzues)** është tërësi imazhesh lëvizëse me ose pa zë, pavarësisht nga kohëzgjatja, e cila është element i veçantë, i krijuar nga përdorues dhe i vendosur në platformë për ndarjen e videos nga vetë përdoruesi ose nga një përdorues tjetër;
- **Dhuna** është çdo shfaqje e sjelljes psikofizike agresive, kërcënim ose qëllim i realizuar, me ose pa armë, për të frikësuar, poshtëruar dhe/ose (vetë) lënduar një individ, grup ose komunitet. Në këtë rast, mund të bëhet fjalë për shfaqjen e dhunës që tashmë është kryer ose për qëllimin e ushtrimit të dhunë, pavarësisht nëse ajo dhunë mund ose nuk mund të shkaktojë lëndim. Termi përfshin gjithashtu dhe çdo përshkrim të pasojave të dëmtimit fizik të ndonjë qenieje të gjallë (ose grupi qeniesh të gjalla), edhe pse akti i dhunës nuk është paraqitur;
- **Erotika** është paraqitja e përshkrimeve, skenave dhe/ose pamjeve të lakuriqësisë së seksualizuar, pavarësisht nga zhanri dhe funksioni programor i materialit audiovizual;
- **Periudhat kohore** janë terma të përcaktuara saktësisht të shërbimit programor të transmetimit të planifikuar për një ditë-natë, të përcaktuara për shfaqjen e materialit audiovizual të kategorizuar sipas grupmohave të (publikut)audiencës së pritur;
- **Konteksti i programit** përfshin: zhanrin e programit; funksioni i programit (informativ,

³ Pornografia e fëmijëve nënkupton: „material pornografik që përshkruan vizualisht akte të qarta seksuale me të mitur ose një të rritur që duket si i mitur, ose tregohet i mitur ose personi i rritur që duket si i mitur në një pozicion të dukshëm seksual, ose fotografi reale që tregojnë qartë aktin seksual me të mitur ose e paraqet të miturin ose personin e moshuar që duket si i mitur në pozicion seksual të dukshëm“ (neni 122 pika 24 të Kodit penal).

⁴ „Dhunë e tepruar është shpërndarja e mesazheve tekstuale, verbale dhe vizuale që në terma programorë të aksesueshme për të miturit, lavdërojnë forma fizike, verbale ose psikologjike të sadizmit ose lloje të ngajshme të dhunës, që është qëllim në vetvete, dhe në asnjë mënyrë nuk mundet të justifikohet as përmes kontekstit të zhanrit as përmes motiveve të veprimit dramatik të programit të shfaqur“ (neni 50 paragrafi (2) të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale).

edukative ose argëtuese); grupi kryesor i synuar në audiencën e mundshme; formati i shërbimit programor; periudhën kohore të programit dhe renditjen e programeve në skemën programore për shërbimet programore televizive; renditja e programeve në katalog sipas kategorive për ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë; shkallën e dëmtimit që mund të shkaktojë çdo përmbajtje programore; numrin dhe përbërjen e pritur të audiencës potenciale dhe pritshmëritë e mundshme të audiencës (publikut); shkallën në të cilën jepen detaje për përmbajtjen për të cilën është informuar audienca e mundshme; efektet shtesë që përmbajtja mund të shkaktojë tek shikuesit, si dhe mundësia e mospërfshirjes së detajeve shqetësuese me dhunë dhe erotizëm të përfshira në materialin audioviziv që planifikohet të shfaqet kur raportohet për tema me rëndësi publike. Aspektet e aplikueshme të kontekstit programor duhet gjithashtu të merren parasysh dhe gjatë organizimit të videove të krijuara nga përdoruesit."

Neni 4

Në kreun "I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME", pas nenit 2 të Rregullores, shtohet neni i ri 2-a, i cili thotë:

"Neni 2-a

Mbrojtja e të dhënave personale të të miturve

Të dhënat personale të të miturve të mbledhura ose në mënyrë tjetër të krijuara ose të marra nga ofruesit e shërbimeve mediatike, gjatë zbatimit të masave të kësaj Rregulloreje, nuk mund të përpunohen për qëllime komerciale, siç janë marketingu i drejtpërdrejtë, profilizimi dhe analiza ose reklamimi i mendimit.

Neni 5

Titulli i Kreut II: **"PERMBAJTJE QË MUND TË NDIKOJNË DËMSHËM MBI TË MITURIT"** ndryshohet si vijon: **"PERMBAJTJE TË TJERA QË MUND TË DËMTOJNË TË MITURIT"**.

Neni 6

Në kreun II **"PERMBAJTJA QË MUND TË NDIKOJNË DËMSHËM MBI TË MINITURIT"** (titulli i të cilit në pajtim me ndryshimet thotë: **"PERMBAJTJE TË TJERA QË MUND TË DËMTOJNË TË MITURIT"**), fjalët "transmetohen në programe" nga paragrafi (3) i nenit 3 (Dhuna) në Rregullore, zëvendësohen me fjalët "shfaqet në përmbajtje".

Neni 7

Në kreun II **"PËRMBAJTJE QË MUND TË NDIKOJNË DËMSHËM MBI TË MITURIT"** (titulli i të cilit në pajtim me këto ndryshime dhe plotësime thotë: **"PËRMBAJTJE TË TJERA QË MUND TË DËMTOJNË TË MITURIT"**), neni 4 i Rregullores (Përdorimi i drogës, substancave psikoaktive, cigareve dhe alkoolit), ndryshohet si vijon:

„Neni 4

Përdorimi i drogës, substancave psikoaktive, cigareve dhe alkoolit

Përdorimi i drogës, substancave psikoaktive, cigareve, cigareve elektronike dhe suplementeve të tyre, si dhe alkoolit, nuk duhet të shfaqen në përmbajtje audiovizuale që janë të destinuara kryesisht për të mitur.

Përmbajtjet audiovizuale që nuk janë të destinuar për të mitur nuk duhet të mbështesin, nxisin, inkurajojnë ose lavdërojnë përdorimin e drogës, substancave psikoaktive, cigareve, cigareve elektronike dhe suplementeve të tyre, si dhe alkoolit, përveç rasteve kur kjo justifikohet nëpërmjet kontekstit të zhanrit ose përmes motiveve të veprimit dramatik në programin artistik".

Neni 8

Në kreun II **“PERMBAJTJA QË MUND TË NDIKOJNË DËMSHËM MBI TË MITURIT”** (titulli i të cilit, në pajtim me ndryshimet dhe plotësimet, thotë: **“PERMBAJTJE TË TJERA QË MUND TË DËMTOJNË TË MITURIT”**), paragrafi (1) i nenit 5 të Rregullores (Erotika), është ndryshuar si vijon:

“Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale janë të detyruar të kenë parasysh se edhe pse në përmbajtjet audiovizuale deri në kufi të caktuar lejohet të shfaqet, përmbajtje të tilla mund të shkaktojë dëme për të miturit. Prandaj kategorizimi i përmbajtjes erotike duhet të bëhet në pajtim me përshkrimet e kategorive të programeve të përcaktuara në Rregullore”.

Neni 9

Në kreun II **“PERMBAJTJA QË MUND TË NDIKOJNË DËMSHËM MBI TË MIMITURIT”** (titulli i të cilit në pajtim me ndryshimet thotë: **“PERMBAJTJE TË TJERA QË MUND TË DËMTOJNË TË MITURIT”**), neni 8 i Rregullores (Format sugjeruese të sjelljes së rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë), është ndryshuar si vijon:

„Neni 8

Modele sugjестive të sjelljes të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë

Për shkak të mbrojtjes së të miturve, shfaqja e përmbajtjes – programeve/videove të krijuara nga përdoruesit/komunikimeve komerciale me përshkrime, skena dhe/ose pamje sjelljesh të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë, të cilat mund të imitohen lehtësisht, duhet gjithmonë të arsyetohet në kontekstin e duhur.”

Neni 10

Në kreun II **„CPËRMBAJTJE QË MUND TË NDIKOJNË DËMSHËM MBI TË MITURIT“** (titulli i të cilit në pajtim me ndryshimet dhe plotësimet thotë: **„DPËRMBAJTJE TË TJERA QË MUND TË DËMTOJNË TË MITURIT“**), neni 9 i Rregullores, është ndryshuar si vijon:

„Neni 9

Shfaqja e praktikave të okultizmit dhe pa recetë

Përmbajtja që përshkruan praktika të okultizmit (çdo lloj magjie, fallzhor) - palmistikë, hamendje, tarot, astrologji, spiritualizëm, etj.) dhe pa përgatitje profesionale duhet të shënohen si programe të kategorisë së pestë që nuk rekomandohen për publikun nën 18 vjeç, dhe transmetuesit mund t'i transmetojnë ekskluzivisht në periudhën nga ora 00:00 deri në orën 05:00.

Okultizmi dhe pa përgatitje profesionale mund të paraqiten ekskluzivisht në kontekst programor jo të dyfishtë si temë argëtuese, informuese dhe/ose edukative, temë humaniste e analizuar, dhe nuk mund nëpërmjet asnjë lloj ndërveprimi të këshillojnë dhe/ose të sugjerojnë ndryshime në sjelljen personale dhe/ose kolektive dhe rrethanave të jetesës, që kanë të bëjnë me shëndetin, financa, punën ose në marrëdhëniet ndërpersonale.

Kufizimi i periudhës së transmetimit nuk vlen për përmbajtjet e shkurtra me horoskop ditor, të klasifikuar si - program me funksion argëtimi”.

Neni 11

Në kreun II **“PERMBAJTJA QË MUND TË NDIKOJNË DËMSHËM MBI TË MITURIT”**, (titulli i të cilit, në pajtim me ndryshimet dhe plotësimet, thotë: **“PERMBAJTJE TJERA QË MUND TË DËMTOJNË TË MITURIT”**), neni 10 i Rregullores ndryshohet si vijon:

„Neni 10 Demonstrimi i procedurave hipnotizuese

Ndalohet prezantimi i materialit audiovizual që, në tërësi ose në disa pjesë të tij, është i specializuar në procedurat e detajuara hipnotizuese.

Hipnoza mund të paraqitet ekskluzivisht e kontekstualizuar si temë argëtuese, informuese dhe/ose edukative, e analizuar në mënyrë humaniste.

Shërbimet programore televizive janë të detyruara që para fillimit dhe pas pushimeve reklamuese në programe të tilla, në ekran, dhe ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, në vend të përshtatshëm në katalog, të publikojnë paralajmërim se programi përmban procedura hipnotizuese."

Neni 12

Në kreun II **“PËRMBAJTJA QË MUND TË NDIKOJNË DËMSHËM MBI TË MITURIT”**, (titulli i të cilit sipas këtyre ndryshimeve dhe plotësimeve thotë: **“PËRMBAJTJE TJERA QË MUND TË DËMTOJNË TË MITURIT”**), pas nenit 10 të Rregullores, shtohen tre nene të reja 10-a, 10- b, dhe 10-c, si vijon:

„Neni 10-a

Përmbajtja me këshilla për lojëra të veçanta fati

Emisione të specializuara të lajmeve dhe revista sportive, si dhe video të krijuara nga përdoruesit, me këshilla për lojëra fati të veçanta (lojëra fati në kazino, lojëra fati në bastore, lojëra fati në automat)⁵ si tërësi ose pjesë të njësive audiovizuale me funksion informativ dhe /ose me veçori mediatike argëtuese që publikut drejtpërdrejtë i sugjeron mundësi për të vënë baste në lojëra të veçanta fati me rrezik financiar, transmetuesit mund t'i transmetojnë ekskluzivisht në periudhën nga ora 00:00 deri në orën 05:00, të shënuar me sinjalin paralajmërues si program i kategorisë së pestë.

Shënimi me sinjal paralajmërues për program të kategorisë së pestë është gjithashtu i detyrueshëm dhe për këtë lloj oferte programore tek ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë.

Neni 10-b

Komunikimet komerciale për lojëra të veçanta fati

Komunikimet komerciale audiovizuale për lojëra të veçanta të fatit duhetqartë dhe dukshëm të shënohen me sinjal paralajmërues për kategorinë e pestë të programit, por mund të shfaqen gjatë gjithë ditë-natës së programimit të transmetuesit, me përjashtim të emisioneve me funksion programor informativ, argëtues dhe edukativ të destinuar kryesisht për fëmijë.

Shënimi me sinjal paralajmërues për program të kategorisë së pestë është gjithashtu i detyrueshëm për komunikimet komerciale audiovizuale për lojërat e veçanta të fatit nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë.

Neni 10-v

Formati i programit⁶ "realist".

Duke qenë se paraqet material të papërpunuar audiovizual me ndërhyrje editoriale minimale ose të maskuar me mjeshtëri, që në raste të caktuara është hibrid i dokumentuar dhe i rigjuar, me motivin parësor regjistrimin e situatave në të cilat sjellja e pjesëmarrësve të rastësishëm ose të përzgjedhur është e paparashikueshme, përmbajtjet që i përkasin formati programet "realiste" duhet me kujdes të kategorizohen në pajtim me kontekstin e programit, me kriteret e klasifikimit dhe me përshkrimet e kategorive të programit, veçanërisht nëse ato përbëhen nga përshkrime, skena dhe/ose pamje që paraqesin dhunë dhe erotizëm.

⁵ Sipas Ligjit për lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.24/11, 51/11, 148/11, 74/12, 171/12, 27/14, 139/14, 61/15, 154/15, 23/16 dhe 178/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.251/22),

⁶ Përshkruar detajisht në pikën 16.11. të „Udhëzimit për mënyrën e klasifikimit të llojeve të programeve audio dhe audiovizuale“.

Neni 13

Në kreun IV "PARALAJMËRIMI AKUSTIK DHE SHENJAT PARALAJMËRUESE-SINJALET PARALAJMËRUESE" neni 19 i Rregullores ndryshohet si vijon:

"Neni 19

Përmbajtja në të cilën aplikohen sinjalet paralajmëruese

Sinjalet paralajmërues detyrimisht aplikohen para fillimit dhe gjatë transmetimit të programeve të shërbimeve programore televizive dhe në vend të përshtatshëm pranë programeve/videove të krijuara nga përdoruesit e disponueshëm në katalogët e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, përkatësisht:

- në të gjitha llojet e programeve artistike, dhe
- në ato lloje programesh/video të krijuara nga përdorues me funksion informues, edukues ose argëtues, të cilat në tërësi ose nëpërmjet pjesëve të tyre, mund të kenë ndikim të dëmshëm për të miturit.

Shërbimet mediatike audiovizuale sipas kërkesës duhet të shënojnë përmbajtjet nga paragrafi (1) i këtij neni dhe gjatë shfaqjes së tyre, në përputhje me kushtet teknike të platformave të shëmbimit të videove/rrjeteve sociale."

Neni 14

Në kreun IV "PARALAJMËRIMI AKUSTIK DHE SHËNJAT PARALAJMËRUESE – SINJALET PARALAJMËRUESE", në nenin 20 të Rregullores, kryhen ndryshimet dhe plotësimet në vijim:

- në paragrafin (2), fjalët "teknika hipnotike" zëvendësohen me fjalët "procedura hipnotizuese".
- pika 3 ndryshohet dhe thotë: "Në katalogët e shërbimeve mediatike audiovizive me kërkesë, në vendin e duhur pranë programeve/videove të parashikuara në nenin 19 të kësaj Rregulloreje, detyrimisht duhet të vendoset vetëm shenja vizuale që i përgjigjet kategorisë së programit dhe gjatë shfaqjes së tyre shënohen me shenjë vizuale, verbalisht ose në mënyrë tjetër të përshtatshme, në varësi të kushteve teknike të platformave të ndarjes së videove/rrjeteve sociale."
- pas paragrafit (3) shtohet paragrafi i ri (4), i cili thotë: "Paralajmërimi i duhur duhet të lexohet dhe para fillimit të programit në radio që sipas kontekstit programor dhe kriterëve të Rregullores për mbrojtjen e të miturve, është potencialisht e dëmshme për publikun e mitur."

Neni 15

Në kreun IV "PARALAJMËRIMI AKUSTIK DHE SHENJAT VIZUALE-SINJALISTIKA PARALAJMËRUESE" në nenin 21 të Rregullores, në pasqyrën tabelare, bëhen ndryshimet në vijim:

- në kolonën "Shenjat vizuale", në rreshtin e parafundit të kolonës, fjalët "teknika hipnotike" zëvendësohen me fjalët "procedurat hipnotizuese" dhe
- në kolonën "Sinjalet paralajmëruese", në rreshtin e parafundit të kolonës, fjalët "teknika hipnotike" zëvendësohen me fjalët "procedura hipnotizuese".

Neni 16

Në kreun VI "DETYRIMET E VEÇANTA PËR SHËRBIMET MEDIATIKE AUDIOVIZUALE ME KËRKESË", neni 27 i Rregullores ndryshohet si vijon:

„Neni 27
Njoftimet promovuese për përmbajtjen

Njoftimet promovuese për përmbajtjen e ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë nuk duhet të përmbajnë përshkrime, skena dhe/ose pamje që mund të dëmtojnë të miturit.

Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, janë të detyruar t'i shënojnë njoftimet promovionale për përmbajtjet që mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e të miturve me shenjë vizuale, verbalisht ose në një mënyrë tjetër të përshtatshme në varësi të kushteve teknike të platformave për ndarjen e videos/rrjeteve sociale.

Informacioni në lidhje me kategorinë e pestë të programeve/videove mund të paraqitet vetëm si pjesë e shërbimit që është i disponueshëm për pagesë, pavarësisht nëse bëhet fjalë për shërbim abonimi apo me pagesë për çdo shikim në veçanti."

Neni 17

Pjesa tjetër e Rregullores për mbrojtjen e të miturve nuk është ndryshuar.

Neni 18

Kjo Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për mbrojtjen e të miturve ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 172/14), hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" , dhe do të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Zëvendës Kryetari i Këshillit,
Selver AJDINI